# Kosova ime

Pasi lexova lekstin "Malli i Atdheut" të Faik Konicës, më lindi ideja të shkruaj edhe unë diçka për atdheun tim, Kosovën.

Kosova ime sa shumë më mungon. Më merr malli për gjyshen dhe gjyshin tim. Më merr malli për shoket e mi. Ne Kosove shkoj kur kam pushime. Duhet të jesh jashtë Kosovës, e të jesh larg për të kuptuar se ç'forcë e ç'bukuri ka për veshtë kjo fjalë: «KOSOVË». Çdo herë që shkoj në Kosovë, shoh gjëra të reja aty. Gjyshja më pret te dera krahapur. Në një shtet tjetër mund ta filloj një jetë tjetër por atdheun tim nuk do ta harroj. Aty u lind nëna ime, aty u lind babai im. Edhe pse u linda në një vend tjetër, Kosova eshtë atdheu im. Ne e vizitojmë gjyshen dhe gjyshin nga ana e babit por edhe gjyshen dhe gjyshin nga ana e mamit, çdo pushim. Unë gëzohem kur shkoj në Kosovë. Unë dhe shoqet e mia shkojmë bashkë në pishinë dhe në shesh. Në Kosovë marr shumë libra shqip dhe i lexoj në Zvicër. Mua shumë më pëlqen Kosova. Edhe ju duhet ta doni atdheun e juaj.

- Era Helmendi, nxënëse e klasës së pestë, në shkollën shqipe Spreitenbach-Zvicër